



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA			
Njësia: Unit:	2AF	Nr. Prot.: Prot. No.:	68/2021
Jednica: Unit:		Br. Prot.:	
Nr. i faqeve: No. of pages:	02	Data: Date:	03.11.2021
Br. stranic: Br. stranica:		Datum:	
Prishtinë/Pe			

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. I REF. 68 /2021

KOMISIONI PËR HAPJEN E OFERTAVE, i emëruar sipas Vendimit me nr ref ZK 231/2021 i datës 04.10.2021 i nxjerrë nga Kryetari i OMK-së, në përbërje të: Dr. Naser Gjonbalaj – Kryetar, Betime Baftiu –anëtare dhe Arbënora Duriqi-Bahtiri –anëtare si dhe në mbështetje të Nenit 16 paragraf 1,2 dhe 3 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK, në mbledhjen e datës 03 nëntor 2021, nxjerrë këtë:

V E N D I M

ANULOHET procedura e prokurimit për tenderin publik nr 06/2021 i datës 19 tetor 2021, për furnizimin e OMK-së me faksimil (vula), për shkak të mospërmbushjes së kushtit themelor të përcaktuar në bazë të Nenit 9 paragraf 2 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK, përkatësisht për shkak të dorëzimit të vetëm dy ofertave nga Operatorët Ekonomik.

A r s y e t i m

Me datë 27 shtator 2021, Këshilli Drejtues i OMK-së nxjerrë Vendimin me nr ref KD 56/2021 për fillimin e procedurave të prokurimit për përzgjedhje të Kompanisë përgjegjëse për furnizimin e OMK-së me faksimilë (vula). Zyra për Administratë dhe Financa, përkatësisht Zyrtari përgjegjës për prokurim pranë OMK-së, pas përgatitjes së specifikacioneve nga Komisioni përkatës i emëruar nga Këshilli Drejtues, bënë shpalljen publike të njoftimit për tender me nr 06/2021 me datë 19.10.2021.

Pas përfundimit të afatit ligjor dhjetë ditësh për dorëzimin e dosjeve të tenderit, ku vetëm dy kompani kanë dorëzuar ofertat e tyre, Komisioni për hapjen e ofertave në përbërje të tre anëtarëve dr. Naser Gjonbalaj- Kryetar, Betime Baftiu –anëtare dhe Arbënora Duriqi- Bahtiri anëtare, në takim të mbajtur me datë 03 nëntor 2021 me fillim në orën 14:00, kanë konstatuar se në këtë fazë të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë dorëzuar vetëm dy oferta nga Operatorët Ekonomik të


interesuar sipas njoftimit për kontratë të publikuar nga OMK, përkatësisht Kompania "Jusuf Shalqini" B.I. me adresë në Prizren dhe përfaqësuar nga Jusuf Shalqini si dhe Kompania "Lumturie Munishi" B.I. me adresë në Prishtinë dhe përfaqësuar nga Lumturie Munishi. Me këtë rast, Komisioni ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet për anulimin e procedurës së prokurimit nr 06/2021 për tenderin për furnizimin e OMK-së me faksimil (vula), për shkak se kanë aplikuar vetëm dy Kompani ofertuese dhe me këtë rast nuk janë përmbushur kushtet dhe kriteret për të vazhduar me procedurën e hapjes së ofertave, meqenëse kusht themelor për të zhvilluar procedurën e hapjes së ofertave është se për ftesën për ofertim të paktën tre (3) operatorë ekonomik duhet të kenë parashtruar ofertat e tyre. Komisioni, poashtu rekomandon që procedura e anuluar e prokurimit të përsëritet jo më larg se 30 (tridhjetë) ditë nga dita kur vendimi me të cilin është anuluar kjo procedurë, është bërë i formës së prerë.

Andaj, në mbështetje të Nenit 9 si dhe Nenit 16 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit të OMK-së, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtrrojë ankesë pranë Këshillit Drejtues të OMK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi.


Komisioni:

Dr. Naser Gjonbalaj –Kryetar



Prishtinë, 03.11.2021

Betime Baftiu – Anëtare



Arbënora Duriqi-Baftiri – Anëtare

